

VENDIM
Nr.134, datë 11.3.2004

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI BASHKISË SË QYTETIT TË RRËSHENIT TË DEGËS
SË MOBILIZIMIT, E CILA ËSHTË NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5,7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dega e mobilizimit në qytetin e Rrëshenit, e cila është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojë në pronësi bashkisë së këtij qyteti, për sistemimin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve.

2. Prona me numër rendor 991, "Dega e mobilizimit" në Rrëshen, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së qytetit të Rrëshenit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, drejtori i zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Rrëshenit të ndjekin procedurat e nevojshme për transferimin e kësaj prone.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano